

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
RICERCA E SERVIZI ALBANIA SH.P.K.**

Sot më datë 22.06.2022, në Tiranë, u paraqit pala e mëposhtme:

- Shoqëria "Ricerca e Servizi S.r.l.", shoqëri e së drejtës italiane, me kod fiskal dhe numër regjistrimi në Regjistrin e Ndërmarrjeve në 16221761006 – N. Rea: RM-1642630, me seli ligjore në Via Ostiense 103, CAP 00154, Romë (RM), Itali, e përfaqësuar nga Z. Artur Asllani, qytetar shqiptar, lindur në Tiran, Shqipëri, më 12.08.1973, me leternjoftim nr. 036542505, sipas Vendimit të Administratorit të Vetem të shoqërisë datë 09.05.2022, i cili i bashkëlidhet këtij akt themelimi (**Shtojca nr. 1**),

e cila ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (ne vijim "**Shoqëria**"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i saj i cili përbenë pjese integrale të këtij akti dhe i bashkëlidhet si "**Shtojca nr. 2**".

**Neni. 1 - Forma**

Shoqëria "Ricerca e Servizi Albania" Sh.p.k. krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni. 2 - Emri**

Emri i Shoqërisë është "Ricerca e Servizi Albania" Sh.p.k.

**Neni. 3 – Objekti i shoqërisë**

3.1 Shoqëria ka për objekt ushtrimin e aktiviteteve vijuese:

- a) menaxhimi i bazave të të dhënave telematike: prodhimi, zhvillimi dhe asistencë e programeve aplikative për informatikën;
- b) studimin dhe krijimin e faqeve të internetit, blogjeve, mediave sociale, banderolave dhe kanaleve dhe formateve të tjera të komunikimit dhe reklamimit në internet dhe celular;
- c) mbështetje strategjike, dizejnim dhe menaxhimin e mediave sociale, rrjeteve sociale dhe projekteve të biznesit social;
- d) studimin dhe krijimin e veprave multimediale;
- e) prodhimin dhe shitjen e platformave dixhitale të internetit, softuerëve multimediale dhe jo-multimedia, offline dhe online, për llogari të vet dhe për llogari të palëve të treta;
- f) blerjen dhe shitjen e hapësirave reklamuese dhe promovuese online dhe offline;
- g) studimin dhe realizimin e kërkimit të tregut, me referencë të veçantë në fushat sociale, kulturore dhe shkencore dhe përkthimin e artikujve profesionalë ndërkombëtarë;
- h) konsulencë për menaxhimin e të gjitha aspekteve që kanë të bëjnë me komunikimin dhe organizimin e kompanisë;
- i) konsulencë krijuese dhe strategjike për hartimin dhe zbatimin e fushatave reklamuese dhe konsulencës teknike dhe operacionale në lidhje me iniciativat e marketingut dhe reklamimit në internet dhe celular;
- j) studimin dhe krijimin e skicave reklamuese, logove, imazheve dhe koncepteve grafike, si në letër, ashtu edhe dixhitale/web;
- k) organizimin e ekspozitave, panairove, kongreseve, konferencave, seminareve, eventeve dhe menaxhimin e tyre komercial e reklamues;
- l) shërbimet e zyrës së shtypit, komunikimi i integruar, marrëdhëniet e jashtme dhe institucionale;
- m) promovimin dhe organizimin e veprimtarive kulturore, artistike, tregtare, reklamuese dhe promovuese të lidhura me to;
- n) botimin e revistave, librave dhe produkteve editoriale, qoftë në formë letre apo dixhitale;
- o) veprimtaritë e formimit profesional bazë dhe të specializuar, me menaxhimin e kurseve edhe në bashkëpunim me shkolla të të gjitha llojeve dhe niveleve,

universitete, organe publike, private dhe profesionale; trajnimi i ofruar si në klasë ashtu edhe në distancë nëpërmjet mjeteve telematike (e-learning, webinar, videokonferencë).

- 3.2 Për qëllim të arritjes së objektivit të Shoqërisë dhe instrumentalisht për këto qëllime, Shoqëria do të mund të kryejë, në emër të vet dhe/ose për llogari të të tretëve, në Shqipëri dhe jashtë saj, të gjitha veprimtaritë financiare, të pasurive të paluajtshme, tregtare, industriale dhe të hipotekave që do të konsiderohen të nevojshme, të dobishme ose të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të Shoqërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, blerjen ose shitjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, marrja e huave dhe kredive edhe duke vendosur hipoteke, me institutet e kredive, banka, shoqëri dhe persona privat; dhenien e garancive personale ose reale edhe në favor të të tretëve, marrja e pjesëmarrjeve dhe interesave në shoqëri të cilat kanë objekte të njejta, të ngjashme apo të lidhur me objektin e shoqërisë, pjesëmarrje në konsorciume apo bashkime të perkoheshme apo grupime shoqërishe. Me në pergjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm në arritjen e qëllimit të Shoqërisë.

#### **Neni 4 - Selia**

Selia e Shoqërisë është në Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 2, Tiranë, Shqipëri

#### **Neni 5 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

#### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind/00) lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e gjitha e nënshkruar dhe shlyer, me vlerë 100 (njëqind/00) lekë dhe e barabartë me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar.

#### **Neni 7 – Kontributet dhe kuotat**

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- Shoqëria "Ricerca e Servizi S.r.l.", ofron një kontribut në para të barabartë me ALL 100 (njëqind/leke), nëpërmjet depozitimit të kësaj shumë pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër.
- 7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:
- Shoqërisë "Ricerca e Servizi S.r.l.", i përket një kuotë, me vlerë nominale ALL 100 (njëqind/leke), që i korrespondon 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

#### **Neni 8 – Transferimi i kuotave**

Kuotat e shoqërisë mund të transferohen në treteve sipas modalitetëve të parashikuara në Statut.

#### **Neni 9 – Administrimi**

- 9.1 Me anë të këtij akti emërohet 1 (një) Administrator i shoqërisë, si vijon:
- Z. Nicola de Chiara, shtetas italian, lindur në Cagliari, Itali, më 5 prill 1964, me banim në Roma, Viale dei Caduti nella Guerra di Liberazione, 125, Itali, me kod fiskal DCHNCL64D05B354M me letërnjoftim nr CA68586HM4, me datë përfundimi 05.04.2031.
- 9.2 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, në përputhje me sa parashikuar nga ky Akti i Themelimit,

Statuti dhe Ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

- 9.3 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të shoqërisë që do të themelohet për regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ai është i autorizuar të nënshkruajë të gjitha aktet dhe të kontraktot në emër të Shoqërisë detyrimet që rrjedhin nga momenti i regjistrimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të delegojë kompetencat e tij edhe te të tretët.

#### Neni 10 –Gjuha


- 10.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe bashkelidhur perkthimi ne gjuhen italiane.
- 10.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në italisht do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërshjt detyrues.

Per Ortakun e Vetem  
**Ricerca e Servizi S.r.l.**



Z. Artur Asllani

Perkthyesë



**STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
RICERCA E SERVIZI ALBANIA SH.P.K.**

Sot më datë 22.06.2022, në Tiranë, u paraqit pala e mëposhtme:

- Shoqëria "**Ricerca e Servizi S.r.l.**", shoqëri e së drejtës italiane, regjistruar në regjistrin e Ndërmarrjeve të Romës, me kod fiskal dhe numër regjistrimi në Regjistrin e Ndërmarrjeve nr. 16221761006 – Nr. Rea: RM-1642630, me seli ligjore në Via Ostiense 103, CAP 00154, Romë (RM), Itali, e përfaqësuar nga Z. Artur Asllani, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, Shqiperi, më 12.08.1973, me banim në Tiranë, Shqiperi, me leternjoftim nr. 036542505, sipas vendimit të Administratorit të Vetem të shoqërisë datë 09.05.2022, i cili i bashkelidhet këtij Statuti (shtojca nr. 1)

i cili ka vendosur të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

**KAPITULLI I  
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1 Shoqëria "Ricerca e Servizi Albania" Sh.p.k. (në vijim "**Shoqëria**") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emri**

Emri i Shoqërisë është Ricerca e Servizi Albania Sh.p.k.

**Neni 3 – Objekti i shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria ka për objekt ushtrimin e aktiviteteve vijuese:
  - a) menaxhimi i bazave të të dhënave telematike: prodhimi, zhvillimi dhe asistenca e programeve aplikative për informatikën;
  - b) studimin dhe krijimin e faqeve të internetit, blogjeve, mediave sociale, banderolave dhe kanaleve dhe formateve të tjera të komunikimit dhe reklamimit në internet dhe celular;
  - c) mbështetje strategjike, dizejnim dhe menaxhimin e mediave sociale, rrjeteve sociale dhe projekteve të biznesit social;
  - d) studimin dhe krijimin e veprave multimediale;
  - e) prodhimin dhe shitjen e platformave dixhitale të internetit, softuerëve multimedialë dhe jo-multimedia, offline dhe online, për llogari të vet dhe për llogari të palëve të treta;
  - f) blerjen dhe shitjen e hapësirave reklamuese dhe promovuese online dhe offline;
  - g) studimin dhe realizimin e kërkimit të tregut, me referencë të veçantë në fushat sociale, kulturore dhe shkencore dhe përkthimin e artikujve profesionalë ndërkombëtarë;
  - h) konsulencë për menaxhimin e të gjitha aspekteve që kanë të bëjnë me komunikimin dhe organizimin e kompanisë;
  - i) konsulencë krijuese dhe strategjike për hartimin dhe zbatimin e fushatave reklamuese dhe konsulencës teknike dhe operacionale në lidhje me iniciativat e marketingut dhe reklamimit në internet dhe celular;
  - j) studimin dhe krijimin e skicave reklamuese, logove, imazheve dhe koncepteve grafike, si në letër, ashtu edhe dixhitale/web;

- k) organizimin e ekspozitave, panairove, kongreseve, konferencave, seminareve, eventeve dhe menaxhimin e tyre komercial e reklamues;
- l) shërbimet e zyrës së shtypit, komunikimi i integruar, marrëdhëniet e jashtme dhe institucionale;
- m) promovimin dhe organizimin e veprimtarive kulturore, artistike, tregtare, reklamuese dhe promovuese të lidhura me to;
- n) botimin e revistave, librave dhe produkteve editoriale, qoftë në formë letre apo dixhitale;
- o) veprimtaritë e formimit profesional bazë dhe të specializuar, me menaxhimin drejtimin e kurseve edhe në bashkëpunim me shkolla të të gjitha llojeve dhe niveleve, universitete, organe publike, private dhe profesionale; trajnimi i ofruar si në klasë ashtu edhe në distancë nëpërmjet mjeteve telematike (e-learning, webinar, videokonferencë).

3.2 Për qëllim të arritjes së objektit të Shoqërisë dhe instrumentalisht për këte qëllim, shoqëria do të mund të kryejë, në emër të vet dhe/ose për llogari të të tretëve, në Shqipëri dhe jashtë saj, të gjitha veprimtaritë financiare, të pasurive të paluajtshme, tregtare, industriale dhe të hipotekave që do të konsiderohen të nevojshme, të dobishme ose të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të Shoqërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, blerjen ose shitje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, marrja e huave dhe kredive edhe duke vendosur hipoteke, me institutet e kredive, banka, shoqëri dhe persona privat; dhenien e garancive personale ose reale edhe në favor të të tretëve, marrja e pjesëmarrjeve dhe interesave në shoqëri të cilat kanë objekte të njëjta, të ngjashme apo të lidhur me objektin e shoqërisë, pjesëmarrje në konsorciume apo bashkime të perkoheshme apo grupime shoqërisë. Me ne përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm në arritjen e qëllimit të Shoqërisë.

#### **Neni 4 – Selia**

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 2, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, hapjen e filialeve, selive dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë, dhe jashtë shtetit.

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja**

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### **KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

#### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind/00) lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e gjitha e nënshkruar dhe shlyer, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin e shoqërisë, përcaktuar nga neni 7 (shtatë) i këtij Statuti.

#### **Neni 7 – Kontributet dhe kuotat**

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Shoqëria "Ricerca e Servizi S.r.l.", ofron një kontribut në para të barabartë me ALL 100 (njqind/leke), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelim e sipër.

#### 7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

- Shoqërisë "Ricerca e Servizi S.r.l.", i përket një kuotë, me vlerë nominale ALL 100 (njqind/leke), që i korrespondon 100% (njqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

### **Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

### **Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

### **Neni 10 – Transferimi i kuotave**

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Përgjithshme.

## **KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL**

### **Neni 11 – Asambleja e përgjithshme dhe kompetencat e saj**

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

- 11.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislativi përkatës.

### **Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë, të paraqesë mendimin e tij dhe të votojë në proporcion me vlerën nominale të kuotës që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me autorizim me shkrim, me anën e së cilit mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë autorizim për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

### **Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, Kuorumi dhe Vendimet**

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorëve dhe/ose ekspertit kontabël, si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve sidhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të totalit të votave në asamblesë të shoqërisë. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton në këtë Statut – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë
- 13.4 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet me thirjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohej atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të paktën të ¾ (tre të katërtat) e ortakëve të



pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.

- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit, Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

#### **Neni 14 – Administrimi**

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, me të drejtë rëmërimi.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e zakonshme dhe jashtëzakonshme, në përputhje me sa parashikohet në këtë Statut, akti i emërimit dhe Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 14.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për akte ose kategori aktesh të veçanta.

#### **Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar**

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

### **KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor**

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kërkuar nga Ligji n. 9901 te dates 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

#### **Neni 17 – Fitimet**

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.



**KAPITULLI V**  
**SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18 – Prishja**

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të kohëzgjatjes së parashikuar nga Statuti ose përpara përfundimit të afatit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statutin të Shoqërisë.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

**Neni 19 – Likuidimi**

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 21 – Gjuha**

- 21.1 Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe bashkelidhur perkthimi në gjuhën italiane.
- 21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në italisht do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërishit detyrues.


ORTAKU I VETËM

Ricerca e Servizi S.r.l.



Z. Artur Asllani

PËRKTHYESE



**ATTO COSTITUTIVO  
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA  
RICERCA E SERVIZI ALBANIA SH.P.K.**

Oggi, il 22.06.2022, in Tirana, si è presentata la seguente parte:

- La società "Ricerca e Servizi S.r.l.s." società di diritto italiano, iscritta al registro delle imprese di Roma, con codice fiscale e numero di iscrizione nel Registro delle Imprese 16221761006 – N. Rea: RM-1642630, con sede legale in Roma (RM), Via Ostiense 103, CAP 00154, Italia, rappresentata dall'Avv. Artur Asllani, cittadino albanese, nato a Tirana, Albania, il 12.08.1973, residente in Tirana, Albania, con carta d'identità n. 036542505, secondo la Determina dell'Amministratore Unico della società del 09.05.2022, che si allega al presente Atto Costitutivo (**Allegato n. 1**),

la quale ha deciso di stipulare il seguente Atto Costitutivo di una società a responsabilità limitata (di seguito la "Società"), la cui attività verrà regolata dalla legislazione albanese in vigore e dal suo Statuto che fa parte integrante di questo atto, al quale è stato allegato come "Allegato n. 2".

**Art. 1 - Forma**

La società "Ricerca e Servizi Albania" Sh.p.k è costituita in forma di società a responsabilità limitata

**Art. 2 - Denominazione**

La denominazione della società è "Ricerca e Servizi Albania" Sh.p.k.

**Art. 3 – Oggetto sociale**

3.1 La società ha per oggetto le seguenti attività:

- a) la gestione di banche dati telematiche: la produzione, lo sviluppo e l'assistenza di programmi applicativi per l'informatica;
- b) lo studio e la realizzazione di siti web, blog, social media, banner e altri canali e formati di comunicazione e pubblicitari online e mobile;
- c) il supporto strategico, l'ideazione e la gestione di progetti di social media, social network e social business;
- d) lo studio e la realizzazione di opere multimediali;
- e) la produzione e la vendita di piattaforme digitali web, software multimediale e non, offline e online, in proprio e per conto terzi;
- f) l'acquisto e la vendita di spazi pubblicitari e promozionali online e offline;
- g) lo studio e la realizzazione di ricerche di mercato, con particolare riferimento nel campo sociale, culturale e scientifico ed alla traduzione di testi articoli professionali internazionali;
- h) la consulenza sulla gestione di tutti gli aspetti relativi alla comunicazione dell'impresa e all'organizzazione dell'azienda;
- i) la consulenza creativa e strategica per l'ideazione e la realizzazione di campagne pubblicitarie e la consulenza tecnica e operativa relativa a iniziative pubblicitarie e di marketing online e mobile;
- j) lo studio e la realizzazione di bozzetti pubblicitari, logotipi, immagini e concept grafici, cartacei e digitali/web;
- k) l'organizzazione di mostre, fiere, congressi, convegni, seminari, eventi e la loro gestione commerciale e pubblicitaria;
- l) i servizi di uffici stampa, comunicazione integrata, relazioni esterne ed istituzionali;
